



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

**SHPALLJE KONKURIMI I HAPUR  
PËR  
VENDE VAKANTE PRANË AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS**

Në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit 111/2018 “Për Kadastrën”, neni 11, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, shpall konkurimin për pozicionet vakante, në Projektin “Digjitalizimi i të Dhënave Kadastrale të Pasurive të Paluajtshme” pranë Drejtorisë Qendra e Kadastrës Digjitale:

**Specialist (20)**, në profilin: *Gjeodezi; Inxhinieri Ndërtimi; Arkitekturë; Gjeoinformatikë*.  
Kategoria IV-3. Niveli minimal i diplomës "Bachelor".

**Lloji i Kontratës:** Kontratë punë me afat të caktuar.

**Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme, si vijon:**

- Kandidatët duhet të zotërojnë diplomë të arsimit të Lartë, nivelit minimal "Bachelor", në profilin e kërkuar.
- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi.
- Preferohet të kenë trajnime apo kualifikime në fushën përkatëse.
- Preferohet të kenë eksperiencë pune në fushën e pronësisë.

**❖ Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit.**

Kandidatët duhet të dorëzojnë fotokopje të dokumentacionit, si më poshtë:

- Kërkesë/letër interesi, për pozicionin për të cilin është i interesuar kandidati.
  - Jetëshkrim (CV)
  - Fotokopje të diplomës Bachelor ose/dhe Master (nëse ka) dhe listës së notave. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet edhe njehsimi nga Ministria e Arsimit;
  - Fotokopje të librezës së punës (*Të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë*);
  - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
  - Çertifikatë familjare
  - Vërtetim të gjendjes shëndetësore,
  - Vërtetim nga prokuroria (që nuk është aktualisht në proces hetimi),
  - Vërtetim nga gjykata (që nuk është në proces gjyqësor penal).
  - Vërtetim të gjendjes gjyqësore/ Formular i vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore
  - Referencë (Rekomandim) nga punëdhënës të mëparshëm
  - Adresën e saktë të vendbanimit, email dhe kontakt telefonik.
  - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- **Dokumentacioni i përcaktuar në pikat “g”, “h”, “i” dhe “j” duhet të jetë lëshuar jo më parë se 3 muaj nga momenti i aplikimit.**

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhet, nëpërmjet postës zyrtare, apo dorazi në Zyrën e Protokollit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK, në adresën: Rr. “Dora D’Istria”, Nr.2, Tiranë.

**Çdo aplikant i cili, brenda afatit të përcaktuar, nuk dërgon të gjithë dokumentacionin e kërkuar, apo paraqet dokumentacion jashtë afatit të vlefshmërisë humbet automatikisht, të drejtën e vijimit të fazës së konkurimit.**

**Dorëzimi i dokumenteve duhet të bëhet brenda datës: 08.04.2024.**

❖ **Shpallja e rezultateve për fazën e verifikimit paraprak të kandidatëve.**

Brenda datës **15.04.2024**, njëسيا e menaxhimit të burimeve njerëzore do të njoftojë kandidatët individualisht, (nëpërmjet adresës së e-mail).

**Vlerësimi i kandidatëve**

Kandidatët që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të nënshtrohen procedurave të mëtejshme të vlerësimit, nga një komision i posaçëm i ngritur për këtë qëllim, në lidhje me:

a – arsimimin, përvojën, trajnimet dhe njohuritë e lidhura me fushën, deri në 40 pikë;

b - intervistën e strukturuar me gojë, deri në 60 pikë

Gjatë intervistës do të vlerësohen në lidhje me: Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me pozicionet për të cilat aplikojnë; Eksperiencën e tyre të mëparshme si dhe motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën).

Komisioni shqyrton dhe vlerëson aplikimet sipas kriterëve të përcaktuara më parë dhe përzgjedh kandidatët më të përshtatshëm.

❖ **Shpallja e rezultateve**

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail të paraqitur në dokumentacionin e aplikimit).

Kandidati që merr më pak se 50 pikë në total nuk konsiderohet i suksesshëm.